



Nr:11/ 567

Dt:14.08.2015

KONKURS PËR REGJISTRIMIN E FËMIJËVE NË ÇERDHËN PUBLIKE PËR FËMIJË NË MALISHEVË

Në bazë të nenit 5, shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës dhe në bazë të Ligjit mbi Edukimin Parashkollor Nr. 02/L-52:

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT (DKA) SHPALL KONKURS PËR REGJISTRIMIN E FËMIJËVE NË ÇERDHËN PËR FËMIJË NË KOMUNËN E MALISHEVËS PËR VITIN SHKOLLOR 2015/2016

Të gjitha detajet rreth grupmohave dhe numrit të planifikuar të fëmijëve që do të regjistrohen mund t'i gjeni në Çerdhën për Fëmijë.

Konkursi do të jetë i hapur prej datës 15 gusht 2014 deri më 28 Gusht 2015.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në Çerdhën për Fëmijë, e cila gjendet në Rrugën: "Hamdi Berisha" p.n- afër Qendrës së Banimit Kolektiv në Lagjën Mirëdita.

Dorëzimi i dokumenteve bëhet çdo ditë pune, prej orës 9 deri në ora 15.

Shpallja e rezultateve bëhet më 31 gusht 2015 në Çerdhën për fëmijë.

Regjistrimi i fëmijëve në Çerdhën për fëmijë bëhet bazuar në Kriteret e Regjistrimit të përcaktuara nga Drejtoria Komunal e Arsimit (DKA), i cili i bashkangjitet këtij konkursi.

KRITERET E PRANIMIT NË ÇERDHËN PËR FËMIJËN

- Të gjithë fëmijët që regjistrohen në Çerdhën për Fëmijë në Malishevë duhet të jenë banorë të komunës së Malishevës. Kjo dëshmohet me Çertifikatën e Vendbanimit e cila merret në Zyrën e Shërbimit Civil.
- Të dorëzohet ekstrakti i lindjes së fëmijës.
- Të dorëzohet plotësuar FletëRegjistrimin, i cili merret në Çerdhën për Fëmijë.
- Të dorëzohet çertifikata shëndetësore për regjistrim në çerdhe. Përfshirë këtu edhe Librezën e vaksinimit të fëmijës.
- Të dorëzohet kopja e kontratës së punës së prindit apo e të dy prindërve.
- Të dorëzohet gjendja e llogarisë për tre muajt e fundit, ose dëshmi nga Trusti Pensional I Kosovës për kryerjen e kontributeve pensionale.

Blerim Thaçi

Drejtori i DKAE-së